



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

BURSA PËR STUDIME TË AVANCUARA MASTER NË ZVICËR

MBI QEVERISJEN EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE

Universiteti i Gjenevës në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Gjenevë ofron bursa për "*Studime të Avancuara Master mbi Qeverisjen Evropiane dhe Ndërkombëtare*" në kuadër të programit MEIG (Master of Advanced Studies in European and International Governance).

Programi i studimeve të avancuara është projektuar për studentë dhe profesionistë, të cilët kanë marrë një diplomë Bachelor dhe synon të transferojë tek pjesëmarrësit njohuritë për çështje rreth qeverisjes evropiane dhe ndërkombëtare. Programi i adresohet gjithashtu studentëve dhe profesionistëve, të cilët punojnë dhe angazhohen në çështjet e qeverisjes në një sektor publik ose privat. Programi MEIG i pajis studentët me aftësitë bazë profesionale dhe përvojë për të drejtuar organizatat ndërkombëtare në këtë fushë specifike.

Programi Master i Studimeve të Avancuara është i hapur për kandidatët që janë të gatshëm të marrin pjesë në Program në tërësi ose vetëm në një ose disa nga modulet e propozuara. Kusht i rëndësishëm është njohja e gjuhës angleze. Gjithashtu mbas përfundimit të këtij programi të gjithë kandidatët janë të detyruar të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Drejtuesit e programit MEIG mund t'i kërkojnë aplikantëve të japin në çdo kohë informacione të mëtejshme, përveç dokumenteve të dorëzuara si pjesë e aplikimit. Një intervistë ose një test me shkrim mund të plotësojë procedurën e pranimit. Aplikimet që nuk janë të plota nuk do të merren në konsideratë.

Studimet e avancuara mbi qeverisjen evropiane dhe ndërkombëtare ofrojnë një kombinim të shkëlqyer të studimeve akademike me trajnimet profesionale. Programi mujor MEIG zgjat nëntë muaj (shtator 2019-korrik 2020) dhe është e organizuar me tetë module tematike dhe metodologjike për çështje që lidhen me qeverisjen. Pas përfundimit të dy moduleve bazë që trajtojnë funksionimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve të Bashkimit Evropian, si aktorë globalë në çështjet e qeverisjes, programi MEIG realizon një numër të gjerë kursesh tematike për të drejtat e njeriut dhe migracionin, mirëmbajtjen dhe promovimin e paqes ndërkombëtare, sigurinë, tregtinë ndërkombëtare, shëndetin dhe mjedisin, si për dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në përfundim pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë një projekt përfundimtar të studimit, i cili përfshin një raport me shkrim mbi një projekt të paracaktuar në kuadrin e aktivitetit profesional të studentit ose një projekt kërkimor në formën e një teze të shkruar mbi një temë që lidhet me programin.

Masa e bursës që ofrohet për studentët e huaj është 45 000 CHF (franga zvicerane) dhe mbulon shpenzimet e regjistrimit dhe të shkollimit, si dhe një pjesë të shpenzimeve të jetesës.

Kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit që gjendet në faqen online të programit MEIG http://www.meig.ch/wp-content/uploads/2018/10/MEIG-Application-form_4th-edition-2019-2020.pdf; Formulari i aplikimit së bashku me të gjithë dokumentacionin e kërkuar duhet të përcillet përmes postës elektronike në adresat:

meig@unige.ch; ose Christine.kaddous@unige.ch ;

ose me postë në adresën:

Master of Advanced Studies in European and International Governance (MEIG Programme)
Centre d'études juridiques européennes
Office 5062
Université de Genève
40, Bd du Pont d'Arve
CH-1211 Geneva 4
Switzerland

Për me tepër informacion lidhur me dokumentacionin dhe procedurën e aplikimit, ju lutemi referojuni faqes së internetit: <http://www.meig.ch/admission/full-programme>.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS